



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, respektivisht Nenin 22, paragrafët 1,2,3,4 dhe 5, Nenin 23, paragrafi, 1, Nenin 24, paragrafët 1 dhe 2, Rregulloren për Vlerësimin e Aplikacioneve për Licencë të KPM-së KPM-2014/02, përkatësisht në nenin 4, paragrafi 7 dhe Raportin e Komisionit të Vlerësimit të aplikacioneve të datës 11 korrik 2023, lidhur me vlerësimin të aplikacioneve, të pranuar në konkursin publik për licencë të radios në gjuhën turke, me mbulim regional, për Komunën e Prizrenit të shpallur më 28 shtator 2022 dhe i cili ka qenë i hapur deri më 28 tetor 2022, Komisioni nxjerr këtë:

VENDIM

1. **REFUZOËHET** kërkesa e kandidatit **Radio Hisar** për licencë të radiove në gjuhën turke për Komunën e Prizrenit për arsye të mungesave në dokumentacionin e aplikimit të dorëzuar në konkursin publik për këtë komunë.

ARSYETIM

2. KPM, me datën 19 shtator 2022, ka marr vendim për shpalljen e konkursin publik për dhënie të një licence për shërbim medial audio (radio) në gjuhën turke, me mbulim regional, për Komunën e Prizrenit. Konkursi është publikuar më datën 28 shtator 2022 dhe ka qenë i hapur për dorëzimin e aplikacioneve deri më datën 28 tetor 2022, ora 16:00.
3. Gjatë kohës sa konkursi publik ka qenë i hapur KPM ka pranuar vetëm një aplikacion për licencë nga kandidati Radio Hisar i cili është dorëzuar më datën 28 tetor 2022.
4. KPM, me qëllim të vlerësimit të aplikacioneve të pranuar gjatë konkursit publik, bazuar në nenin 4, paragrafi 7, të Rregullores KPM-2014/02, ka formimin e Komisionit për Vlerësimin e aplikacioneve.
5. Komisioni konstaton se Komisioni Vlerësues i aplikacioneve në takimin e tij të datës 11 korrik 2023 ka vlerësuar aplikacionin e kandidatit Radio Hisar dhe në bazë të këtij vlerësimi është konstatuar se ka mungesë të këtyre dokumenteve: dëshmi mbi qëndrueshmëri financiare, skemën programore javore, lista e kompletuar e pajisjeve së bashku me projektin teknik, diploma dhe dëshmia mbi përvojën e punës për personin përgjegjës për çështje ligjore, dëshmia mbi përvojën e punës dhe kualifikimi universitar për personin përgjegjës për çështje teknike dhe dëshmia nga gjykata për anëtarët e bordit lidhur me dënimet penale/procedurë penale.
6. Bazuar në arsyetimin si më lartë Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.
7. Këtë vendim e lëshon Komisioni dhe i njëjti hyn në fuqi nga data e nënshkrimit.

Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediav



17.07.2023

datë